



VENDIM

Nr. 25, Datë 15.02.2017

MBI

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR.169 DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE NR. 103 DATË 23.06.2016 , “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, pika “P”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.02.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Bordit të ERE nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

Konstatohet se:

- Mbështetur në nenin 19 gërma “1“ ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për: i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik
- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 4118 Prot., datë 01.02.2017, në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, konstaton vështirësi në implementimin në afat të rregullave të përcaktuara në Rregulloren për

procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sa përket ndërtimit të platformës IT.

- ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE nr. 103 datë 23.06.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër:

Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të Vendimit të Bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në Vendimin e ERE nr.103, datë 23.06.2016, Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” si më poshtë:
 - *“Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi brenda datës 30.04.2017”.*
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI